

7.10.2010

**Botuar me shkurtime nga Telegraf (8.10.2010) dhe botuar i plote nga Zeri
popullit (9.10.2010)**

PROMEMORJE DREJTUAR INSTITUCIONEVE DREJTUESE TË VENDIT PËR T'I DHËNË FUND ANARKISË 19 VJEÇARE TË PRONËS

Të nderuar drejtues të Shtetit Shqiptar ! Falenderojmë politikën për vendimin e Parlamentit Evropian për liberalizimin e vizave, dita e pritur nga të gjithë shqiptarët. Besojmë se Parlamenti Evropian do të qëndrojë koherent me parimet e deklaratës së Helsinkit dhe të drejtave të njeriut, që të kujdeset për të kthyer fizikisht tek i zoti trojet turistike të nacionalizuara gjatë diktaturës, duke anuluar trafikun e tyre të bërë prej oligarkisë së pushtetarëve postkomunistë. Lidhur me pronën ne falenderojmë dhe besojmë në përgjigjet e marra nga autoritetet e larta, deputetët dhe komisionerët e nderuar të B.E. Catherine Ashton, Cecilia Malstöm, Yves Leterme, Isil Gachet, Viviane Reding, Van Rompuy, Mavlut Çavuşoğlu, Liane Adler, Wolfgang Rau, Štefan Füle etj si dhe një fjalë të thënë para dy javësh nga Kryetarja e Kuvendit zonja Jozefina Topalli

Me këtë rast, nëpërmjet medias i drejtojmë këtë memorie Presidentit të Republikës z. Bamir Topi, Kryetares së Kuvendit znj. Jozefina Topalli, Kryeministrit z. Sali Berisha, Qeverisë dhe Kuvendit të Shqipërisë, pasi kanë kaluar 19 vjet që pronat akoma nuk janë kthyer tek i zoti. Vendimi për vizat nuk është dita jonë, për sa kohë ky vendim nuk plotësohet nga ana juaj me kthimin fizik të pronës tek i zoti . Mjaft me demagogjinë për kompensim. Kompensim jepini shkelësve të ligjit apo kujdo tjetër por ne nuk keni asnjë të drejtë të na mohoni trojet e të parëve. Problemi më i rëndësishëm dhe më shqetësues për popullin e Shqipërisë së jugut është shkelja e të drejtës së pronës nga vetë Shteti. Ju ftojme që detyrimin për të zbatuar Kushtetutën, duke bërë korigjimin e gabimeve të tranzicionit dhe kthimin fizik të pronës tek i zoti ta vlerësoni si një çështje me rëndësi kombëtare. Politika e deritanishme antipronar që nuk respekton të drejtën e pronësisë dhe origjinën e pronës po mashtron ndërkombëtarët , ka futur në sherr dhe konflikt qytetarët ndërmjet tyre me qëllim që të pushtetarët të përvetësojnë trojet turistike. Legjislacioni aktual për pronat vazhdon të ketë në themel kulturën e vjedhjes që realizohet nëpërmjet ligjeve dhe pushtetit klanor, duke zbatuar frymën e platformës së Katovicës. Kjo platformë dhe ky mentalitet synon të eliminohen pronarët e ligjshëm dhe të krijohen pronarë të rinj. Pronat e shtetëzuara nga regjimi komunist që duhet ti ktheheshin pronarit të ligjshëm që në vitin 1991, vazhdojnë të trajtohen si prona në dispozicion të qeveritarëve, që i miratojnë dhe që i ndryshojnë ligjet sipas interesave të grupit. Ishte pikërisht ligji 7501 i miratuar në 1991 që i hapi rrugën anarkisë për tokat e ish kooperativave bujqësore dhe VKM nr 161 dt 8.04.1993 për tokat e ish fermave. Ligjet që rodhën më pas përfshi dhe ligjin aktual 9235, janë baza e anarkisë së pronës e korrupsionit në administratën shtetërore dhe në sistemin e drejtësisë. Strategjia e mos respektimit të të drejtës së pronësisë, ka provokuar shumë vrasje dhe shumë efekte negative, duke përfshirë konfliktet midis

familjeve dhe konflikte edhe brenda familjes. Ne mendojmë se ju si drejtues të institucioneve drejtuese të Shtetit keni përgjegjësi për vazhdimësinë e anarkisë së pronës dhe për Kushtetutën që vazhdon të shkelet. Rikujtojmë se prej vitit 1998, nuk është marrë asnjë inisiativë ligjore në zbatim të nenit 181 të Kushtetutës që të korrigojë trafikun e pronave tona dhe vjedhjet e pushtetarëve të pas vitit 1991. Këtë qëndrim antipronar ne e kemi denoncuar dhe e denoncojmë publikisht si antidemokratik. Praktikisht duke na mohuar pronën e trashëguar ne pronarëve na keni mohuar atdheun dhe Shqipërinë e keni nxjerrë në ankand.

Problemi i pronës në zonat turistike zgjidhet shpejt, pa vështirësi dhe pa pasur nevojë për fonde monetare, nëse nga ana juaj nuk do të mungojë vullneti politik për të zbatuar të drejtën e pronësisë në përputhje me nenet 181 dhe 41 të Kushtetutës. Vështirësitë i krijojnë ligjet aktuale ku përfitojnë klanet që komandojnë pushtetarët që janë të korruptuar. Deklarimi i Kryemnistrit Berisha që të hetohet jashtë çdo imuniteti korrupsioni për cdo akuzë të lidhes së politikës me mafien, teorikisht është i mirë por ai devijon nga objektivi i saj nëse “Inspektoriat për Verifikimin e Origjinës së Pasurive”, nuk verifikon më parë se cilat janë pronat e shtetit dhe pronat që shteti i ka shtetëzuar në regjimin komunist. Nëse z. Berisha do kërkojë transparencën duke filluar nga Shteti, komisioni do të duhet të deklarojë se i korruptuari më i madh është vetë shteti i pas vitit 1991, që nuk zbaton detyrimet kushtetuese, sepse ka operuar dhe ka miratuar ligje dhe VKM, që bien ndesh me nenin 181 dhe 41 të Kushtetutës.

Të ndreuar drejtues të Shtetit: Sot është në dorën tuaj që populli të dali urgjentisht nga ky qorrsokak. Mos vazhdoni ta pengoni kthimin e pronës tek i zoti, mos filloni ta kërkonin korrupsionin tek kusetërit dhe deputetët hajdutë. Këta i përkasin fazës së dytë pasi ata janë thërime, degëza ose cironka të vogla para padrejtësisë dhe vjedhjes që po bën Shteti i pas vitit 1991 mbi pronarët e ligjshëm. Nëse rregulloni legjislacionin dhe zhdukni korrupsionin shtetëror gjërat do shkojnë në rrugën e drejtë dhe korrupsioni do të ulet shumë.

Legjislacioni aktual ka shkelur të drejtën e pronës dhe ka bllokuar edhe mundësinë e pronarëve të ligjshëm që ti drejtohen rrugës gjyqësore. Ligji nuk përcakton se sa është afati kohor që pronari duhet të presi të marri vendim të firmosur nga kryetari i Agjencisë z. Elvis Çefa dhe pas kalimit të këtij afati pronari i shpronësuar nga diktatura të ketë të drejtë që ti drejtohet gjykatës. Të gjithë pronarët mbeten në rradhë për të kaluar nëpër vrimën e gjëlpërës së një personi të vetëm, që është drejtori i AKKP. Pronarët po sorrollaten dhe riciklohen nëpër gjyqe pasi ligji nuk përcakton se sa është afati maksimal i kohës pas të cilit një proces gjyqësor duhet të mbarojë nga shkalla e parë dhe në sa kohë duhet të mbarojë shkallën e dytë. Ju lutemi mos vazhdoni të na quani dhe të na trajtoni si ish-pronarë ndërsa ata që shkelin ligjet që pushtojnë dhe ndërtojnë pa leje i legalizoni dhe i quani pronarë, duke u shitur apo falur tokat tona. I gjithë ky kompleks veprimesh përbën strategjinë e Katovicës për të ricikluar në pushtet dhe në politikë klane që do të përfitojnë pronat e pronarëve të shpronësuar dhe pasuritë që i

përkasin shtetit. Kjo politikë 19 vjeçare ka sjellë përplasje të shumta dhe ka dalë në sipërfaqe. Javët e fundit në fshatin Dukat të Vlorës pronarët u ngritën në protesta dhe kërkojnë pronat sipas kufijve që kanë pasur para kolektivizimit komunist. Shoqata Bregdeti ashtu dhe Shoqata Kombëtare "Pronësi me Drejtësi" përkrahim të drejtën e pronësisë për të shpronësuarit dhe të drejtën e përdorimit për të trtetët pra përkrahim kërkesën për kthimin fizik të pronës tek i zoti dhe kompensimi të parashikohet vetëm për ato prona që deri në vitin 1991 janë zënë me ndërtime banimi ose për prona që vazhdojnë të shfrytëzohen për nevoja publike. Përballë këtyre kërkesave që përputhen me nenin 181 të Kushtatutës janë ngritur disa familje të Orikumit që protestojnë në mënyrë të verbër në mbrojtje të ligjit antikombëtar dhe famëkeq 7501 apo të pronave që kanë përfituar me VKM nr 161 dt 6.4.1993. Kjo pjesë e legjislacionit i përket kulturës së vjedhjes prandaj ju bëjmë APEL ju si drejtues të shtetit të merrni masa të shpejta që këto ligje dhe vendime si dhe vendime të tjera të ngjashme që tjetersojnë tokat e ish Ndërmarjeve Bujqësore, duhet të abrogohet sa më parë nga Kuvendi i Shqipërisë. Në të kundërt e keqja për Shqipërinë buron nga politikanët, që justifikojnë vjedhjen e pronarëve dhe shkaktojnë anarkinë e pronës. Këto ligje krijojnë konflikte midis pronarëve dhe atyre që duan të përfitojnë tokën me pretendimin absurd sepse paskan punar në ish fermat bujqësore në kohën e diktaturës. Sipas kësaj llogjike ata që kanë punuar gjithë jetën si policë roje të burgut në kohën e diktaturës tani ju takon të privatizojnë qelitë apo zyrat e burgut , arsimtarët të privatizojnë klasat etj. !!!

Komisioni për shqyrtimin e konfliktit të Orikumit nuk ka pse të ketë vështirësi nëse do të zbatohet nenet 41 dhe 181 të Kushtatutës por gjithsesi zgjidhje nuk mund të ketë për sa kohë Kryeministri dhe ju drejtuesit e shtetit nuk keni vullnetin politik për të zbatuar liritë dhe të drejtat e njeriut, të drejtën tonë të patjetërsueshme që të na kthehet me ligj prona që diktatura na shtetëzoi padrejtësisht dhe të na shlyhet edhe dëmi moral dhe material i shkaktuar në këto 19 vjet tranzicion anarkik dhe pseudodemokratik. Nga kjo anarki të gjitha palët po të dalim të humbur. Duke falenderuar mediat që kanë mbështetur fuqimisht zgjidhjen e problemit të pronës presim reflektimin tuaj, reagimin dhe angazhimin tuaj publik për të rregulluar realisht gabimet , për të kthyer në origjinë pronat tona të trafikuar, për të ndëshkuar hajdutërinë postkomuniste me trojet ne zonat turistike të bregdetit. Zgjidhje a përgjithshme dhe dinjitoze për ju do të ishte duke miratuar me procedurë të shpejtuar një ligji që përputhet me Kushtatutën dhe të thotë se prona i kthehet të zotit sipas parimit se prona është blerë, e dhuruar ose e trashëguar. Të sqarohen të gjithë njëherë e përgjithmonë se prona asnjëherë nuk fitohet me grabitje edhe sikur grabitësi të jetë vetë shteti.

Nga Kryesia e Shoqates Bregdeti